

VENDIM
Nr. 393, datë 19.6.2024

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA SHKODËR, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “AGJENCIA RRENC”, ME VENDNDODHJE NË RRENC, SHKODËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër, të pronës, me emërtimin “Agjencia Rrenc”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, me numër pasurie 19/2, zona kadastrale 3168, Shkodër, me sipërfaqe totale 31 165 (tridhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m², sipas plan-rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për realizimin e projektit të ndërtimit të strehëzës së qenve endacakë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)”, të ndryshuar, hiqet prona, me emërtimin “Agjencia Rrenc”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës”.

4. Bashkisë Shkodër i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ia japë atë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI
Prona "Agjencia Rrenc" Rrenc, Shkodër

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM (DPRMSH) Datë 26/02/2024 QËLLIMI: Transferim nga MM (DPRMSH) te Bashkia Shkodër

VENDNDODHJA

Bashkia Shkodër ZVASHK Shkodër Nr.Pasurisë 19/2 Z.K 3168 Indeksi i Hartës K-34-64- (210-A,B)


TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë Sip e pasurisë 31165m² Sip e gjurmës së ndërtimit 2353.1m² Nr. kateve Nr. pemeve

Nord = 4658661.76
East = 462263.66

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4658661.76
East = 462703.57



SHPJEGUESE:

Kufiri sipas Hartes Kadastrale dhe Faktit
Sip.e pergj. = 31165m²
Objektet sipas faktit
Sip. e pergj. e gjurmës së ndërtimit të objekteve
= 2353.1m² (objektet janë të rrënuara)

Nord = 4658310.69
East = 462263.66

SH 1: 2500

METRA

Nord = 4658310.69
East = 462703.57

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Ven			Pasuria nr. 19	K51726024H
2	Lindje			Pasuria nr. 19/ 328	
3	Jug			Pasuria nr. 19/4/ 328	
4	Perëndim			Pasuria nr. 19/4	

REALIZOI PËR IGJIU
Topograf Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI Mark. Teuta KANXHERI

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas gjendjes faktike në terren dhe HTR.
Shënim: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Drejtorisë së
Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit nr.344, datë 26.02.2024, bazuar në
dokumentacionin hartografik arkivor, dokumentacionit të pronësisë b/lidhur
shkresës (Certifikatë Registrimi Pronësie, Kartela e Pasurisë së Paluajtshme, HTR)

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM (DPRMSH)

MIRATOHET
Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit
Robert HYSENLLARI